

KONTRATA SOCIALE POGRADEC

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

GUSHT 2019 - GUSHT 2020

PËRGATITUR NGA:
RINIA PËR INTEGRIM, AKTIVIZIM DHE SENSIBILIZIM

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

TË KONTRATËS SOCIALE

BASHKIA POGRADEÇ

PROGRAMI: POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE
Gusht 2019 – Gusht 2020

1



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim



Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile
Civil Society Development Center



Association for the Regulation of the Civil Society



"Young Intellectuals, Hope"
"Intelektualët e rinj, Shpresa"



Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve, projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:
Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë;
Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
Qendra Rinore Vlorës,
Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
Epoka e Re, Fier;
Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
Qendra Rinore për Progres, Kukës,
Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec.

Ky Raport nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve, Organizatës “Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim”.

Tabela Përmbledhëse

SHKURTIME	4
FALENDERIME.....	5
HYRJE.....	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	7
PROCESI I FORMULIMIT TË PRIORITETEVE TË KONTRATËS SOCIALE	10
KËSHILLI BASHKIAK DHE VEPRIMTARIA E TIJ NGA KONSTITUIMI E DERI NË 30.06.2020.....	11
MONITORIMI I MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK PAS KONSTITUIMIT TË TIJ.	14
ANALIZA E 10 PRIORITETEVE KRYESORE.....	18
PRIORITETI 1: KRIJIMI E NJË SEKTORI DEDIKUAR TË RINJVE, NDRYSHIM NË ORGANIGRAMËN E BASHKISË POGRADEC KU BRENDA DREJTORISË SË KULTURËS, SPORTIT, TURIZMIT DHE RINISË TË KRIJOHET NJË SEKTOR DEDIKUAR TË RINJVE	18
PRIORITETI 2: DETAJIMI I ZËRIT TË BUXHETIT PËR TË RINJTË PËR TË MBËSHTETUR REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË PLANIFIKUARA.	19
PRIORITET 3: NGRITJA DHE KRIJIMI I NJË QENDRE RINORE.....	20
PRIORITET 4: RIKONSTRUKSIONI I BIBLIOTEKËS SË QYTETIT DHE SHITIMIT TË FONDIT TË LIBRIT.....	20
PRIORITET 5: ADRESIMI PËR RIKONSTRUKSIONIN E SHKOLLAVE NË QYTETIN E POGRADECIT DHE NDËRTIMI I PALESTRAVE DHE PAJISJA ME BAZË MATERIAL NË SHKOLLAT EKZISTUESE.	21
PRIORITET 6: SHITIMI I KËNDEVE TË LOJRAVE ME STANDARTE PËR FËMIJËT.	21
PRIORITET 7: ZHVILLIMI I PROGRAMEVE NË LIDHJE ME NXITJEN E BIZNESIT NGA TË RINJTË DHE/APO GRATË. PARASHIKIMI NË BUXHET PËR KRIJIMIN E NJË FONDI “START-UP” PËR TË RINJTË.	21
PRIORITET 8: KRIJIMI I PROGRAMEVE TË BASHKISË- INTERSHIP ME PAGESË-PËR NXITJEN E PUNËSIMIT NË PËRGJITHËSI DHE PROGRAME TË VEÇANTA ME PRIORITET TË RINJTË DHE GRATË.	21
PRIORITET 9: RITJIA E INFORMIMIT DHE ADRESIMI I PËRMIRËSIMIT TË KOMUNIKIMIT MES QYTETARËVE DHE PUNONJËSVE TË BASHKISË, NË ZYRAT E INFORMACIONIT DHE JO VETËM. RESPEKTIMI I MEKANIZMAVE PËR TRANSPARENCËN E PUBLIKIMEVE.	22
PRIORITET 10: BUXHETIM ME PJESËMARRJE, PROCES TRANSPARENT DHE GJITHËPËRFSHIRËS NË MËNYRË QË PJESËMARRËSIT TË MARRIN PJESË NË VENDIMMARRJEN MBI MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE TË PUSHTETIT LOKAL.....	22
REKOMANDIME	25
ANEKS 1	26

Shkurtime

NE	Ndihmë Ekonomike
NJA	Njësi Administrative
KMACP	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë
KEMP	Asistencë për paaftësi për punë
Fëmijët me AK	Fëmijë me aftësi të kufizuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministratave
POP	Përballja e Ofertave Politike

Falenderime

Falenderojmë Bashkinë Pogradec, në veçanti Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, për përgjigjen e shpejtë dhe brenda afatit kohor si dhe Këshillin Bashkiak Pogradec, për vënien në dispozicion të vendimeve të marra. Falenderojmë veçanërisht qytetarët që pranuan ti përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) të cilët po bëjnë një punë shumë të mirë pranë territoreve ku operojnë në mbështetje të komunitetit.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED – National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohesh ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

Hyrje

Gjatë vitit 2019 organizatat e Rrjetit POP zbatuan projektin "Përballja e Ofertave Politike - 2019 (POP 2019)" në 9 bashki të vendit: Tiranë, Durrës, Kukës, Pukë, Vlorë, Fier, Kamëz, Pogradec, Shkodër. Përgjatë vitit 2019 u arrit që të nënshkruheshin Kontrata Sociale, të hartuara në bazë të prioriteteve të komunitetit, midis kryetarëve të rinj të bashkive dhe përfaqësuesve të organizatave anëtare të POP që veprojnë në bashkitë e sipër përmendura.

Gjatë vitit 2020 projekti vijon me "Monitorimin e zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal." Gjatë kësaj faze të kësaj nisme, POP synon që të llojë dhe të advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve që janë nënshkruar në Kontratën Sociale për bashkitë: Tiranë, Kamëz, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Kukës, Pukë dhe Pogradec, gjithashtu synon përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje. Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të kontratës sociale për periudhën gusht 2019 – gusht 2020.

Kjo periudhë përfshin procesin e konsolidimit të Qeverisjes Vendore, njohjen me prioritetet e Kontratës Sociale, deklarimin publik të Kontratës Sociale në një takim të hapur me aktorët kryesorë vendorë si dhe monitorimin e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak dhe zbatimin e prioriteteve të Kontratës Sociale.

Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, RIAS, për një periudhë të rëndësishme të vitit 2020, ka përshtatur aktivitetet për të ndjekur reagimin e pushtetit qendror e lokal si dhe problemet e komunitetit në përshtatje me protokollet e sigurisë.

Gjatë muajve gusht 2019 - gusht 2020 organizata kishte si qëllim:

- Të prezantonte prioritetet e Kontratës Sociale dhe procesin e hartimit të tyre;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve sidomos në kuadër të Dimensionit Social, Transparencës dhe Llogaridhënies.

Gjatë muajve Mars – Qershor 2020 një fokus i veçantë iu kushtua menaxhimit të situatës COVID-19, vendimmarjes nga Këshilli Bashkiak dhe menaxhimit të pandemisë nga Bashkia Pogradec¹.

Përmbledhje Ekzekutive

- Bashkia Pogradec, sipas njoftimeve në faqen zyrtare në Facebook, lajmëron se ka ngritur ekipin e koordinatorëve të lagjeve dhe fshatrave në njësitë përkatëse. Ata do të jenë personat e parë të trajtimit të ankesave apo problematikave nga më të voglat deri tek më të ndërlikuarat.
- Bashkia Pogradec ka nisur investimet për përmirësimet e rrugëve të ndryshme në zonat administrative dhe në fshatra. Sipas një publikimi nga bashkia “Në Dardhas-Osnat-Niçë po punohet për rehabilitimin e këtij aksi, deri në financimin e plotë të projektit që kemi për këtë rrugë. Nuk do të mungojë mirëmbajtja e saj me mjetet e bashkisë për të bërë të mundur lëvizjen e banorëve.”
- Këshilli Bashkiak, që nga konstituimi i tij, ka vijuar punën normalisht duke u mbledhur të paktën një herë në muaj ose më shumë në varësi të nevojave. Për periudhën Mars-Maj, që është edhe periudha e kufizimeve të lëvizjes për shkak të pandemisë botërore COVID-19, Këshilli Bashkiak i ka realizuar mbledhjet në distancë nëpërmjet programeve të internetit, pra nëpërmjet takimeve online. Diskutimet e Këshillit janë publikuar në rrjetin social Facebook të Këshillit Bashkiak.²

¹ https://popalbania.info/wp-content/uploads/2020/05/Raporti_Bashkia-Pogradec_COVID-19-19-1.pdf

² https://www.Facebook.com/watch/live/?extid=0&v=292815715046268&ref=watch_permalink
<https://www.Facebook.com/110757260459936/posts/140254024176926/?extid=0&d=n>

- Sipas Rregullores Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Bashkiak Pogradec: “Njoftimi për zhvillimin e mbledhjes së këshillit për këshilltarët dhe qytetarët bëhet si rregull jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të mbledhjes. Kur në rend të ditës janë çështje të tilla si buxheti apo paketa fiskale, njoftimi për këshilltarët duhet të bëhet jo më pak se 10 ditë para datës së mbledhjes”. Kjo dispozitë është zbatuar gjithmonë, dhe për transparencë me qytetarët njoftimet për mbledhjen e Këshillit Bashkiak janë afishuar në Këndin Informativ, i cili ndodhet përpara Bashkisë së Pogradecit.
- Përsa i përket njoftimit online, Këshilli Bashkiak Pogradec ka hapur faqen e tij në Facebook në 15 Janar 2020, dhe si fillim janë publikuar vetëm vendimet e Këshillit Bashkiak. Duke nisur nga muaji Maj dhe në vazhdim janë publikuar edhe njoftimet për mbledhje së bashku me rendin e ditës.
- Këshilli Bashkiak ka miratuar disa akte sociale që kanë të bëjnë me Programin e Subvencionimit të interesave të kredisë bankare, ndihmë financiare për familjet që kanë pësuar dëmtime nga rënia e zjarrit, rrëshqitja e tokës.
 - Krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit në kuadër të situatës së krijuar nga COVID-19.
 - Dhënien bursë për maturantët ekselentë.
 - Privatizim i banesave shtetërore që kanë mbetur pa u privatizuar.
 - Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2023.
 - Mbështetje ekonomike për familjet që kanë pësuar dëmtime nga zjarret apo rrëshqitja e tokës.
- Në lidhje me prioritetet e kontratës sociale rezulton se janë bërë hapa pozitivë nga ana e Bashkisë Pogradec në disa fusha.
- Minoriteti rom dhe egjiptian kanë qenë përfitues të banesave sociale që u ndërtuan ose u rikonstuktuan nga Bashkia në të gjithë territorin e saj.

Gjetje nga përgjigjet e Bashkisë dhe monitorimi i faqeve zyrtare përgjatë periudhës së COVID-19, Mars –Qershor 2020:

- Bazuar në informacionet zyrtare dhe monitorimin e realizuar nuk rezulton asnjë rast me COVID-19 në Pogradec, duke e bërë një nga zonat e gjelbra.

- Gjatë muajve Shkurt dhe Mars, 4498 familje kanë qenë përfitues të ndihmës ekonomike nga Bashkia Pogradec. Nga këto, 720 familje janë ndihmuar edhe me shërbime të tjera nga Bashkia.
- Janë 5031 persona që trajtohen me Kemp nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMACP), nga të cilat 2566 janë burra dhe 2465 gra. 169 persona nga kjo kategori janë mbështetur dhe me shërbime të tjera.
- Përgjatë muajit Mars dhe Prill janë raportuar tre raste dhune në familje, të treja nga gra.
- Sipas të dhënave zyrtare, janë 5540 familje nga Komuniteti Rom & Egjiptian në Pogradec dhe në rrethinat e tij.
- Janë 7 persona me statusin e Jetimit në Bashkinë Pogradec, prej të cilëve 5 janë burra dhe 2 gra.
- Janë vetëm 2 raste të vajza-nëna në Bashkinë Pogradec.
- Janë asistuar me shërbime të ndryshme 1512 pensionistë. Nga këto, Bashkia Pogradec ka identifikuar rreth 128 pensionistë që jetojnë vetëm dhe që familjarët ju jetojnë jashtë vendit. Nuk kemi informacion për ndarjen gjinore, por sipas Bashkisë janë me projeksion më të madh të gjinisë mashkullore.
- Sipas monitorimit të faqes zyrtare të Bashkisë Pogradec në Facebook, nga data 1 Prill deri më datë 30 Prill, rezulton që: nëpërmjet bashkëpunimit me organizata, fondacione dhe biznese të ndryshme, Bashkia Pogradec ka mundur pajisjen me pako ushqimore të 2675 familjeve nga zona dhe kategori të ndryshme të Pogradecit.
- Përmbajtja e paketës ka qenë në varësi të donatorit dhe shpërndarja e tyre është bazuar në sasinë dhe në numrin e anëtarëve të familjes;
- Nga i njeiti burim (faqja zyrtare ne Facebook) mësojmë që Bashkia Pogradec në bashkëpunim me biznese të ndryshme ka marrë përsipër furnizimin me 3 vakte ngrënie të 55 shtetasve shqiptarë që janë të akomoduar tek Hotel “Euro Korça” në Pogradec për 14 ditë.
- Sipas të dhënave nga bashkia, rezulton që për muajin Mars janë 2593 familje që i janë shpërndarë ndihma dhe i janë ofruar shërbime të ndryshme.
- Nuk ka ndarje gjinore për shumë nga të dhënat që morëm nga Bashkia Pogradec. Kjo na pengon të analizojmë gjetjet nga pikëpamja gjinore.
- Ndarja gjinore pasqyrohet për nënkategoritë: a) Personat që trajtohen me Kemp b) Jetimë c) rastet e dhunës në familje.

- Nuk ka shtim të pagesave për personat me aftësi të kufizuar si dhe për ata me ndihmë ekonomike gjatë muajit mars 2020.

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë përgjatë periudhës së COVID-19, Mars 2020-Qershor 2020

- Sipas intervistave në Gur të Kuq, ku ndodhen rreth 50 familje Rome & Egjiptiane, grupet e intervistuar shprehen që janë ndihmuar me pako ushqimore nga OJF dhe kanë mbetur të kënaqur nga përmbatja.
- Gjithashtu, nga intervista të tjera me qytetarët që kanë përfituar pako, ato shprehen të kënaqur nga pako që kanë marrë nga bashkia. *(1 pako përmbante ushqimet bazë të shportës, 1 thes me miell, vaj, sheqer, kripë, makarona, oriz dhe detergjentë)
- Sipas intervistave me familjarët dhe personat me AK, rezulton që pagesa ka kaluar pa problem dhe nuk ka pasur as ulje dhe as rritje të saj.
- Sipas intervistave me personat që përfitojnë nga ndihma ekonomike, rezulton që ka pasur dyfishim të kësaj pagese për muajin Mars 2020.
- Sipas intervistave me qytetarët, nuk ka pasur probleme në marrjen e pensionit dhe bashkia ka vënë në dispozicion një nr. telefoni (për çdo njësi administrative një person/ numër telefoni përgjegjës) për të dërguar pensionet në shtëpi.
- Pjesa më e madhe e nxënësve që jetojnë në qytet dhe në fshatrat afër qytetit e kanë ndjekur mësimin në distancë.
- Qytetarët shprehen që në fillim ishin të frikësuar dhe mosbesues por i kanë mbështetur masat dhe shpresojnë që ekonomia të rimëkëmbet sa më parë.

PROCESI I FORMULIMIT TË PRIORITETEVE TË KONTRATËS SOCIALE

Për identifikimin e prioriteteve të komunitetit për Bashkinë Pogradec, u realizuan 6 forume me banorë të Bashkisë Pogradec përgjatë muajit mars 2019, me qëllim identifikimin e prioriteteve të zhvillimit vendor në këndvështrimin qytetar. Në secilin prej forumeve u përfshinë qytetarë të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, si dhe studentë, shtëpiake apo persona të grupeve të marginalizuara.

Në secilin prej forumeve të zhvilluara, qytetarët diskutuan gjerësisht mbi çështje të ndryshme që përfshihen në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor:

1. Zhvillimi ekonomik vendor;
2. Shërbimet publike;
3. Dimensioni social;
4. Demokracia vendore.

Për secilën prej çështjeve të shtruara për diskutim, qytetarët dhanë këndvështrimin e tyre mbi gjendjen aktuale si dhe diskutuan mbi prioritetet të cilat sipas tyre duhet të përfshihen në agjendën e të zgjedhurve vendor.

Mbi bazën e vlerësimit të vetë pjesëmarrësve, prioritetet e komunitetit u organizuan në dy grupe:

1. Ndërhyrje prioritare, ku përfshihen çështjet që në këndvështrimin e komunitetit janë shumë të rëndësishme për ta dhe kërkojnë më shumë angazhim në vijim nga të zgjedhurit vendorë;
2. Ndërhyrje disi prioritare, që përfshijnë ato çështje që janë më pak të rëndësishme krahasuar me grupin e parë;

U formuluan dhe listuan sipas shkallës së rëndësisë nga vetë komuniteti 47 prioritete.

LOBIMI DHE MONITORIMI I VAZHDUESHEM

Gjatë vitit 2020 është vijuar me “Monitorimin e zbatimit të Kontratës Sociale në nivel lokal.”

POP synon që të llojë dhe të advokojë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve që janë nënshkruar në Kontratën Sociale për bashkitë: Tiranë, Kamëz, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Kukës, Pukë dhe Pogradec, gjithashtu synon përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje. Organizata “Rinia Për Integrim Aktivizim dhe Sensibilizim” në bashkëpunim me komunitetin dhe Bordin Rinor Këshillimor, ka monitoruar pushtetin lokal në lidhje me prioritetet e formuluar në Kontratën Sociale 2019 për Bashkinë Pogradec.

Me datë 23.06.2019 u firmos Kontrata Sociale me 10 prioritetet më të rëndësishme ndërmjet kandidatit për Kryetar Bashkie Z. Ilir Xhakolli dhe organizatës RIAS.

Këshilli Bashkiak dhe veprimtaria e tij nga konstituimi e deri në 30.06.2020.

Mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të hapura për publikun.

Çdo qytetari i lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara nga këshilli dhe në media. Njoftimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

Mbledhja e Këshillit:

Mbledhja thërritet me kërkesën e Kryetarit të Bashkisë me shkrim të jo më pak se 1/3-ës së anëtarëve të tij; e motivuar prej prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.

Mbledhja quhet e vlefshme kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë tjetër për marrjen e vendimeve.

Me kërkesën e Kryetarit të Bashkisë ose të 1/5-tës së anëtarëve të Këshillit Bashkiak, mbledhjet e Këshillit Bashkiak mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar jo më pak se 3/5-tat e gjithë anëtarëve të tij.

Vendimarrja e Këshillit ndahet në:

- Vendimarrja me ose pa konsultim publik.
- Vendimarrja sipas pjesëmarrjes së këshilltarëve në votim.

Publikimi i akteve të Këshillit Bashkiak:

Aktet e Këshillit Bashkiak publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Aktet shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Këshilli i Bashkisë Pogradec

Struktura:

•Këshilltarë 31

Raporti gjinor: 15 Femra , 16 meshkuj, në përqindje 49% femra dhe 51% meshkuj.

- Kryetar i Këshillit Bashkiak Z.Sotiraq Mëngri
- Zv/ Kryetar i Këshillit Bashkiak Znj.Manjola Kamolli
- Zv/ Kryetare e Këshillit Bashkiak Znj. Kostandina Gjoka
- Sekretar i Këshillit Bashkiak Znj.Jona Bojko

12



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Raporti gjinor nuk është ruajtur në strukturat drejtuese të Këshillit Bashkiak ku, siç vihet re, Kryetari i Këshillit është mashkull dhe zëvendës kryetar janë dy femra. Sekretar një femër. Raporti në total 3 femra dhe 1 mashkull.

Komisionet e Këshillit Bashkiak Pogradec

Në total janë krijuar 7 Komisione.

1. Komisioni i Mandateve, Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare, Komisioni i Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve.
2. Komisioni i Etikës, Standarteve dhe Apelimeve.
3. Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare, i Ekonomisë Vendore, Turizimit dhe Zhvillimit Rural.
4. Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve.
5. Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit.
6. Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit, i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjimore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut, Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes.
7. Komisioni i Shëndetësisë, Veterinarisë, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit; Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të Ujrave, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Biodiversitetit.

Nga 7 Komisione që ka Këshilli i Bashkisë Pogradec, ato të cilat përbëjnë interes për POP dhe prioritetet e dala nga komuniteti janë vijueset:

- Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare, i Ekonomisë Vendore, Turizimit dhe Zhvillimit Rural.
- Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit, i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjimore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut, Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes.

- Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve.
- Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit, Komisioni i zhvillimit ekonomik dhe turizmit.

Monitorimi i Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pas konstituimit të tij.

Mbledhja e parë e Këshillit Bashkiak, është zhvilluar duke u bazuar në nenin 48, pika 1, të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”. *“Këshilli Bashkiak e zhvillon mbledhjen e tij të parë, jo më vonë se 20 ditë nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.”*

Ndërsa pika 2 e nenit 48 e ligjit Nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” përcakton: *“Mbledhja e parë e këshillit thirret nga sekretari i Këshillit Bashkiak. Në mungesë të tij, nismën për thirrjen e mbledhjes së parë e merr prefekti”*.

Në mungesë të sekretarit të këshillit dhe në situatën e tensionit politik të krijuar, ishte Prefekti i Qarkut Korçë që njoftoi thirrjen e mbledhjes së parë të Këshillit Bashkiak. Mbledhja u zhvillua me datë 16.08.2019. Kjo mbledhje nuk u zhvillua në ambientet e Këshillit Bashkiak në Bashkinë Pogradec për arsye të tensioni politik të krijuar. Kjo mbledhje u zhvillua në ambientet e Hotel “Enkelana”.

Vendimet që u moren ishin:

1. Vendim Nr. 1: Dt. 16.08.2019, për ngritjen e komisionit të mandateve.
2. Vendim Nr. 2: Dt. 16.08.2019, për vërtetimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit Bashkiak Pogradec.
3. Vendim Nr. 3: Dt. 16.08.2019, për emërimin e kryetarit të Këshillit Bashkiak Pogradec.
4. Vendim Nr. 4: Dt. 16.08.2019, për zgjedhjen e zv.kryetarëve të Këshillit Bashkiak Pogradec.
5. Vendim Nr. 5: Dt. 16.08.2019, për miratimin e përfaqësuesve të Këshillit Bashkiak Pogradec në Këshillin e Qarkut Korçë.
6. Vendim Nr. 6: Dt. 16.08.2019, për emërimin e sekretarit të Këshillit Bashkiak Pogradec.

LËNDA: Dërgohen vendimet e mbledhjes së datës 24.09.2019 të Këshillit të Bashkisë Pogradec

PREFEKTIT TË QARKUT KORÇË

Vendimi nr.90: Fillimin e procedurave të ankandit me objekt prerjen, transportin dhe shitjen e materialit drusor të shkukur dhe të thyer nga dëbora por i përdorshëm në këmbë dhe të rrëzuar.

LËNDA: Dërgohen vendimet e mbledhjes së datës 28.01.2020 të Këshillit të Bashkisë Pogradec

PREFEKTIT TË QARKUT KORÇË

Vendimi nr.3: Për miratimin e kalendarit buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe të buxhetit vjetor 2020, Bashkia Pogradec.

Vendimi nr.4: Për disa ndryshime në pikën 3 të vendimit nr.115, datë 27.12.2019 “Për Miratimin dhe Detajimin e Buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2020”.

Vendimi nr.5: Propozim për hapjen dhe funksionimin e institucionit arsimor publik parashkollor “Kopsht”, në fshatin Homçan, Njësia Administrative Proptisht.

Vendimi nr.6: Propozim për hapjen dhe funksionimin e institucionit arsimor publik parashkollor “Kopsht”, në fshatin Losnik, Njësia Administrative Velçan.

LËNDA: Dërgohen vendimet e mbledhjes së datës 05.03.2020 të Këshillit të Bashkisë Pogradec

PREFEKTIT TË QARKUT KORÇË

Vendimi nr.33: Për miratimin e kërkesës së personave që do të vazhdojnë procedurën e privatizimit të banesave shtetërore që kanë mbetur të paprivatizuara.

Vendimi nr.34: Për krijimin e Këshillit artistik-kulturor.

Vendimi nr.35: Për miratimin e tabelës së honorareve të shpërblimit të personelit të jashtëm, i angazhuar në veprimtarinë dhe projektet e Qendrës Kulturore “Lasgush Poradeci” dhe Bashkisë Pogradec.

Vendimi nr.36: Për miratimin e nivelit të pagave dhe punonjësve të Bashkisë Pogradec dhe ndërmarrjeve në varësi.

Vendimi nr.37: Për disa ndryshime në akt-marrëveshje nr.18, datë 31.01.2012 “Për vendosjen e taksave dhe tarifave vendore tek ndërmarrja UK sh. a”.

Vendimi nr.38: Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Pogradec, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor, për akordimin e ndihmës financiare Z. Kastriot Zeneli, për shkak të dëmtimit të banesës nga rënia e zjarrit.

Vendimi nr.39: Për “Hartën e përgjithshme për plazhet e lejuara”.

Vendimi nr.40: Për Miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Pogradec.

Vendimi nr.41: Për “Miratimin E Rregullores së Këshillit, Kodin e Sjelljes dhe i Parandalimit të Konfliktit të Interesave të Këshilltarëve Bashkiak të Këshillit Bashkisë Pogradec.

Vendimi nr.42: Për Miratimin e Rregullores së Këshillit Bashkiak për Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak Pogradec me Publikun dhe Median (Konsultimeve).

LËNDA: Dërgohen vendimet e mbledhjes së datës 07.04.2020 të Këshillit të Bashkisë Pogradec

PREFEKTIT TË QARKUT KORÇË

Vendim nr.46: Për krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit në kuadër të situatës së krijuar nga përhapja e infeksionit COVID-19.

LËNDA: Dërgohen vendimet e mbledhjes së datës 29.04.2020 të Këshillit të Bashkisë Pogradec

PREFEKTIT TË QARKUT KORÇË

Vendim nr.48: Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, për periudhën 1–31 Mars 2020.

Vendim nr.49: Për një ndryshim në vendimin nr. 115 datë 27.12.2019 për miratimin dhe detajimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Pogradec.

Vendim nr.50: Për shtyrjen e afateve të aplikimit për programin social të strehimit për subvencionimin e interesave të kredisë në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit COVID-19.

Vendim nr.51: Për miratimin në parim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Pogradec për objektin “Rikonstruksioni i rrugës Pogradec – Tushemisht”.

Vendim nr.52: Për miratim Rezolutë” Mbi marrjen e masave të veçanta për shkak të situatës së krijuar si rezultati pandemisë të shkaktuar nga COVID-19.

LËNDA: Dërgohen vendimet e mbledhjes së datës 13.05.2020 të Këshillit të Bashkisë Pogradec

PREFEKTIT TË QARKUT KORÇË

Vendim nr.55: Për disa ndryshime në paketën fiskale 2020 në kuadër të situatës së krijuar nga përhapja e infeksioni COVID-19.

LËNDA: Dërgohen vendimet e mbledhjes së datës 27.08.2020 të Këshillit të Bashkisë Pogradec

PREFEKTIT TË QARKUT KORÇË

Vendim nr.83: Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2021-2023 të Bashkisë Pogradec.

Vendim nr.84: Për një korrigjim në VKB Nr. 79 dt. 23.07.2020 “Për një ndryshim në vendimin Nr. 47 dt.29.04.2020, “Për një ndryshim në vendimin Nr. 115 dt. 27.12.2019, për miratimin dhe detajimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Pogradec, për vitin 2020.

Vendim nr.85: Për miratimin e listës së sipërfaqes së tokës prej 23,47 ha e ndodhur në Njësitë Administrative Proptisht, Cërravë, Udënisht, Trebinjë, që mund të jepen me qera.

Vendim nr.86: Për dhënien e ndihmës financiare Znj. Albina Jolla për shkak të dëmtimit të banesës, nga amortizimi”.

Vendim nr.88: Për miratimin e ndryshimit të vendimit Nr. 46, dt. 25.04.2019 “Për dhënien e ndihmës financiare familjes të Z. Ardian Llapushi në Bashkinë Pogradec, për shkak të dëmtimit të banesës, shkaktuar nga rrëshqitja e tokës.

Vendim nr.90: Për disa ndryshime në Paketën Fiskale 2020 në kuadër të situatës së krijuar nga përhapja e infeksionit COVID-19.

Vendim nr.91: Krijim servitut kalimi.

Analiza e 10 prioritetëve kryesore

Prioriteti 1: Krijimin e një sektori dedikuar të rinjve, ndryshim në organigramën e Bashkisë Pogradec ku brenda Drejtorisë së Kulturës, Sportit, Turizmit dhe Rinisë të krijohet një sektor dedikuar të rinjve.

Ky prioritet u vendos pasi shikohet me shumë rëndësi që të rinjtë të kenë një sektor të dedikuar dhe të menaxhuar nga vetë ato.

Për këtë pikë, Bashkia Pogradec ka komunikuar që ka ngritur një sektor pranë Drejtorisë së Kulturës, Sportit, Turizmit dhe Rinisë ku dhe janë punësuar dy të rinj. Ky sektor, sipas njoftimeve të Bashkisë Pogradec, ka organizuar një sërë aktiviteteve në zbatim të planit të punës duke përfshirë tema si; sensibilizime për të rinjtë dhe gratë, kujdesi ndaj mjedisit, përkujtim ngjarjesh historike dhe të personaliteteve të Pogradecit, nxitja dhe frekuentimi i sporteve të ndryshme si; hiking, shëtitje me kanoe, pasurimi i Bibliotekës Rinore dhe nxitje e të rinjve për të qenë pjesë e Qendrës Rinore.

Tabela e organigramës për Drejtorinë:

Drejtoria e Turizmit, Kulturës dhe Rinisë	10			
Drejtor	1	N/C	II- b	
Spektori i Promocionit dhe Zhvillimit të Turizmit	6			
Specialist për zhvillimin e turizmit	1	N/C	IV- b	
Specialist për organizimin e eventeve	2	N/C	IV- b	
Punonjës për promocionin turistik	1	K i punës		
Punonjës për informacionin turistik	2	K i punës		
Spektori i Kulturës dhe Rinisë	3			
Specialist për kulturën	1	N/C	IV-b	
Punonjës për rininë	2	Kodi i punës	IV- b	

Prioriteti 2: Detajimi i zërit të buxhetit për të rinjtë për të mbështetur realizimin e projekteve të planifikuara.

Çdo nismë, politikë apo iniciativë qëndron vetëm si një ide nëse bashkarisht me të nuk planifikohet dhe alokohet një zë buxhetor. Për këtë, një nga kërkesat e prioritetëve ka qenë detajimi i zërit të buxhetit për të rinjtë. Ky detajim do krijonte një transparencë dhe lexim më të qartë mbi zhvillimet për këtë target grup.

Bashkia Pogradec njofton që ka nisur rialokimin e një fondi specifik për Sektorin e Rinisë dhe ndërkohë përgjatë vitit ka mbështetur iniciativat të ndryshme nga të rinjtë.

Disa nisma të të rinjve, që janë mbështetur dhe nga Bashkia Pogradec janë “Eksploro Grunjasin” dhe “Të rinjtë udhëtojnë- Të ecësh Përmes së Bukurës dhe Kulturës”



Regional Cooperation Council
Provided by the RCC Tourism Development and Promotion Project's Grant Programme

European Union
This Project is funded by the European Union

Nucleus Albania

FTESE

PROMOVIMI I AKTIVITETEVE TË PROJEKTI "TË RINJË UDHËTOJNË - TË ECËSH PËRMES SË BUKURËS DHE KULTURËS"

Nucleus Albania si zbatues e Projektit "RCC Triple-P Tourism in South East Europe", ka kënaqësinë t'ju ftojë të merrni pjesë në aktivitetin promovues të produkteve turistike të realizuara nga ky projekt.

Bashkëpunimi ndërkufitar Shqipëri - Maqedoni e Veriut si dhe bashkëpunimi ndërshtetëror: gastronomi, artizanat, shërbime akomoduese, trashëgimi kulturore dhe turizëm aventurë, përbëjnë fokusin e produkteve turistike të realizuara nga projekti.

Ky aktivitet do të zhvillohet ditën e shtunë, datë 15 Gusht 2020, nga ora 9:00 deri në orën 20:00, në ambientet e "Luadhi Çelës Agroturizëm" Pogradec (km 20 në drejtim të fshatit Peshkëpi), ku do të kemi mundësi të paraqesim elementët e zinxhirit të një turizmi të qëndrueshëm nga ferma tek produkti; nga artizanat tek akomodimi; nga kultura te bukuritë natyrore; nga turet turistike në këmbë tek ato me biçikleta; nga muzika tek tradita.

Bashkëngitur do të gjeni programin e aktivitetit.

Jeni të mirëseardhur,

Përzemërsisht

Valbona PALUKA

Email: valbona.paluka@nucleus.al

Mob: 0692058466

This invitation was produced through a grant provided by the Regional Cooperation Council's Tourism Development and Promotion Project, funded by the European Union. Its contents are the sole responsibility of Nucleus Albania and do not necessarily reflect the views of the Regional Cooperation Council or the European Union.

19

Prioritet 3: Ngritja dhe krijimi i një Qendre Rinore.

Nëpërmjet një projekti, Bashkia Pogradec ka ngritur një ambient që do të funksionojë si Qendër Rinore. Ky ambient është ngritur pranë qendrës Kulturore të Fëmijëve. Qendra u inagurua në Maj 2020. Ky ambjenti do të jetë provizor pasi sipas komunikimeve me Bashkinë Pogradec, po shikohet për një ambjent më të madh pranë Drilonit. “Mendojmë se kemi një shans të mirë që të kemi një godinë që do të kemi një qendër rinore që do të na kenë zili”- është shprehur nenkryetarja



Prioritet 4: Rikonstruksioni i Bibliotekës së qytetit dhe shtimit të fondit të librit.

Bashkia Pogradec për këtë prioritet ka njoftuar që: *“Biblioteka e qytetit është pasuruar me fonde për librat dhe ky proces do të vazhdojë dhe në të ardhmen. Rikonstruktimi i Bibliotekës dhe pasurimi i saj me literaturë bashkëkohore, janë prioritete të Bashkisë Pogradec dhe realizimi i tyre është planifikuar të bëhet brenda një afati të shkurtër kohor”.*

është bërë një procedurë për përzgjedhjen e librave të rinj që do të futen në bibliotekë sipas kërkesës. Jemi në përfundimin e përzgjedhjes së librave që do të hyjnë. Në lidhje me rikonstrukcionin Bashkia Pogradec u shpreh që rikonstruksioni i ambjentëve dhe fasades është kryer por pranon që kushtet brenda kanë mungesa si ngrohja; për këtë është bërë një kërkesë nga drejtori i qendrës kulturore për tu financuar. Gjithashtu u shprehen që kanë marrë një propozim për te ngritur këndin e arkivit, ku do të ketë një kënd për shfrytëzim dokumentash për të marrë informacion nga kjo drejtori. Për këtë do të ketë një shtim personeli dhe dy

kompjutera për të shfrytëzuar dokumenta dhe foto të cilat drejtorja e përgjithshme e arkivave i ka hedhur online.

Prioritet 5: Adresimi për rikonstruksionin e shkollave në qytetin e Pogradecit dhe ndërtimi i palestrave dhe pajisja me bazë materiale në shkollat ekzistuese.

Bashkia Pogradec deklaron që ka mbaruar rikonstruksionin e shkollave dhe gjithashtu ndërtimi i palestrave pranë tyre për shkollat në qytet. Sipas komunikimeve me qytetaret ka probleme në shkollat në njësitet administrative jashtë Pogradecit.

Prioritet 6: Shtimi i këndeve të lojrave me standarte për fëmijët.

Gjatë sezonit turistik u investua në mirëmbajtjen e këndeve të lojrave për fëmijët dhe ka nisur puna për përmirësimin e standarteve.

Ndërkohë për këndet e lojrave në zonat administrative jashtë Pogradecit, pjesa më e madhe thonë që nuk kanë kënde, nuk kanë as ambiente ku të ndërtohen, dhe në Velçan dhe Proptisht ka dhe mungesë të fëmijëve. Në Hudenisht kjo çështje shikohet me rëndësi ku një nga banorët shprehet se: *“Mungesë të këndeve të lojrave (nuk ka patur ndonjëherë). Është i nevojshëm rikonstruktimi i hapësirave ku fëmijët të kalojnë kohën e lirë”*

Sipas komunikimit me Bashkinë Pogradec mësuam që: *“Së shpejti, janë planifikuar dhe projektuar disa kënde lojrash në pikat hyrëse të qytetit, tek shëtitorja kryesore por edhe në brendi të pallatave, në sheshet e lira të pallatave, është planifikuar të ngrihen disa kënde lojrash. Duhet më tepër më tepër insistim për shtimin e këtyre këndeve”*

Prioritet 7: Zhvillimi i programeve në lidhje me nxitjen e biznesit nga të rinjtë dhe/apo gratë. Parashikimi në buxhet për krijimin e një fondi “start-up” për të rinjtë.

Nuk ka zhvillim.

Prioritet 8: Krijimi i Programeve të Bashkisë- Intership me pagesë-për nxitjen e punësimit në përgjithësi dhe programe të veçanta me prioritet të rinjtë dhe gratë.

Nuk ka Zhvillim.

Prioritet 9: Rritja e informimit dhe adresimi i përmirësimit të komunikimit mes qytetarëve dhe punonjësve të Bashkisë, në zyrat e informacionit dhe jo vetëm. Respektimi i mekanizmave për transparencën e publikimeve.

Përsa i përket përmirësimit të komunikimit mes qytetarëve dhe punonjësve të Bashkisë Pogradec, aktualisht janë vendosur në funksion zyrat e ADISA-s, të cilat lehtësojnë komunikimin me standartizim të procedurave, digjitalizim të shërbimit dhe ngritjen e sistemeve të informacionit ku qytetarët mund të drejtohen lirisht për të parashtruar kërkesat e tyre.

Prioritet 10: Buxhetim me pjesëmarrje, proces transparent dhe gjithëpërfshirës në mënyrë që pjesëmarrësit të marrin pjesë në vendimmarrjen mbi menaxhimin e financave publike të pushtetit lokal.

Në tetor të vitit 2019, Bashkia Pogradec ka nisur procesin e buxhetimit me pjesëmarrje duke realizuar disa takime me komunitetin dhe grupet e interesit. Takimet për projekt-buxhetin e 2020 u realizuan me Komunitetin Rom dhe Egjiptian, grupe të artistave, biznese, banorë të qytetit etj.

“Bashkia ka bërë dëgjesa publike, por duhet të ketë ritakime për të parë çfarë është bërë dhe çfarë jo” - shprehen qytetarët

Prioriteti	Përmbushur
Prioriteti 1: Krijimin e një sektori dedikuar të rinjve, ndryshim në organigramën e Bashkisë Pogradec ku brenda Drejtorisë së Kulturës, Sportit, Turizmit dhe Rinisë të krijohet një sektor dedikuar të rinjve.	80%
Prioriteti 2: Detajimi i zërit të buxhetit për të rinjtë për të mbështetur realizimin e projekteve të planifikuara.	0%
Prioritet 3: Ngritja dhe krijimi i një Qendre Rinore.	60%
Prioritet 4: Rikonstruksioni i Bibliotekës së qytetit dhe shtimit të fondit të librit.	70%
Prioritet 5: Adresimi për rikonstruksionin e shkollave në qytetin e Pogradecit dhe ndërtimi i palestrave dhe pajisja me bazë materiale në shkollat ekzistuese.	80%
Prioritet 6: Shtimi i këndeve të lojrave me standarte për fëmijët.	0%
Prioritet 7: Zhvillimi i programeve në lidhje me nxitjen e biznesit nga të rinjtë dhe/apo gratë. Parashikimi në buxhet për krijimin e një fondi “start-up” për të rinjtë.	0%
Prioritet 8: Krijimi i Programeve të Bashkisë- Intership me pagesë-për nxitjen e punësimit në përgjithësi dhe programe të veçanta me prioritet të rinjtë dhe gratë.	0%

Prioritet 9: Rritja e informimit dhe adresimi i përmirësimit të komunikimit mes qytetarëve dhe punonjësve të Bashkisë, në zyrat e infomacionit dhe jo vetëm. Respektimi i mekanizmave për transparencën e publikimeve.	60%
Prioritet 10: Buxhetim me pjesëmarrje, proces transparent dhe gjithëpërfshirës në mënyrë që pjesëmarrësit të marrin pjesë në vendimmarrjen mbi menaxhimin e financave publike të pushtetit lokal.	60%

RIAS mirëkupton që procesi i konsultimit për shkak edhe të pandemisë nuk është zhvilluar në mënyrën e duhur. Për forcimin e bashkëpunimit dhe realizimit të prioriteteve, RIAS shikon si të rëndësishme këto rekomandime:

Rekomandime

1. Nevojitet më tepër bashkëpunim me organizatat jo fitimprurëse dhe grupet e interesit për të zhvilluar një proces efektiv konsultimi.
2. Të rritet fokusi i investimeve dhe ndjekjes me prioritet të problematikave në zonat rurale dhe njësitë administrative të tjera jashtë qytetit.
3. Këshilli Bashkiak duhet të rrisë transparencën dhe takimet me banorët e tij, si dhe të rrisë bashkëpunimet me organizatat për programe të ndryshme.
4. Të raportohen dhe investimet e mëdha në mbledhjet e Këshillit Bashkiak, si dhe këto mbledhje të transmetohen dhe live në faqen e Facebook-ut.
5. Në kushtet e Pandemisë Globale nevojitet të zhvillohen mjetet e komunikimit elektronik aplikacione mobile, blog, rrjete sociale, komunikime online, video konferenca etj., ku qytetarët kanë lehtësi aksesit dhe përdorim më i thjeshtëzuar i gjuhës, sidomos për në zonat rurale.
6. Këshilli Bashkiak ka miratuar disa lehtësi fiskale dhe nevojitet më tepër informacion për përfituesit në lidhje me lehtësitë e ofruara.
7. Të mbështeten dhe të inkurajohet pjesëmarrja e të rinjve në vendimarrje dhe në krijimin e mundësive në programe të ndryshme (shembull: Programi i intershipeve me pagesë që ofrohet nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve).

Aneks 1

Nr. Prot. 02

Pogradec, 29.07.2020

KËRKESË PËR INFORMACION Bazuar në Ligjin Nr.119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”

Drejtuar: Z. Ilir Xhakolli, Kryetar i Bashkisë Pogradec

Lënda: Kërkesë për Informacion në lidhje me ecurinë dhe zhvillimin e realizimit të objektivave të Kontrates Sociale.

I nderuar Z. Xhakolli, Kryetar i Bashkisë Pogradec,

Urojmë të jeni mirë me shëndet e punë. Ju ndjekim vazhdimisht në punën tuaj të përditshme dhe ju përgëzojmë për gjithçka jeni duke bërë për Bashkinë tonë në përgjithësi e në këtë periudhë të vështirë.

Sikurse dhe jeni në dijeni, përpara zgjedhjeve lokale, në muajin Qershor 2019, JU keni nënshkruar Kontratën Sociale POP, e cila përmban prioritetet kryesore dedikuar më shumë të rinjve. Kjo Kontratë gjithashtu është firmosur nga përfaqësues të organizatës RIAS dhe Bordit Rinor Këshillimor Pogradec.

Prioritetet e vendosura në kontratë kanë dalë si rezultat i takimeve me qytetarët e Pogradecit. Kjo kontratë është rifreskuar edhe në takimin e zhvilluar në datën 16 Dhjetor 2019 me Bordin Rinor Këshillimor Pogradec, ku është firmosur edhe Marrëveshja e Bashkëpunimit në kuadër të projektit POP 2019. Ne jemi të bindur që ju keni punuar gjatë 2019 dhe po punoni në 2020 për t'i realizuar ato, megjithë fatkeqësitë e mëdha si COVID-19.

Nëpërmjet kësaj kërkesë, NE dëshirojmë që të kemi informacion mbi hapat që janë ndërmarrë ose jo mbi të gjitha pikat që janë shtruar në këtë kontratë dhe nëse ka një plan ose program konkret dhe afat kohor të përcaktuar për realizimin e tyre në vazhdimësi.

Më poshtë ju lutem gjeni dhe njëherë prioritetet:

26



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleancë Gjimore për Zhvillim



CSDC
Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile
Civil Society Development Center



- qendrat rinore e vlorës
V.Y.C.
- vlorë youth center



Association for Integration of Young Adults



"Young Intellectuals, Hope"
IRSH
"Intelektualët e rinj, Shpresa"



lëvizja rinore
për demokraci



Center for
Youth Progress



rias



ER

Prioritet 1: Krijimin e një sektori dedikuar të rinjve, ndryshim në organigramën e Bashkisë Pogradec ku brenda Drejtorisë së Kulturës, Sportit, Turizmit dhe Rinisë të krijohet një sektor dedikuar të rinjve.

Prioritet 2: Detajimi i zërit të buxhetit për të rinjtë për të mbështetur realizimin e projekteve të planifikuara.

Prioritet 3: Ngritja dhe krijimi i një Qendre Rinore.

Prioritet 4: Rikonstruksioni i Bibliotekës së qytetit dhe shtimit të fondit të librit.

Prioritet 5: Adresimi për rikonstruksionin e shkollave në qytetin e Pogradecit dhe ndërtimi i palestrave dhe pajisja me bazë materiale në shkollat ekzistuese.

Prioritet 6: Shtimi i këndeve të lojrave për fëmijë me standarte.

Prioritet 7: Zhvillimi i programeve në lidhje me nxitjen e biznesit nga të rinjtë dhe/apo gratë. Parashikimi në buxhet për krijimin e një fondi “start-up” për të rinjtë.

Prioritet 8: Krijimi i Programeve të Bashkisë- Intership me pagesë-për nxitjen e punësimit në përgjithësi dhe programe të veçanta me prioritet të rinjtë dhe gratë.

Prioritet 9: Rritja e informimit dhe adresimi i përmirësimit të komunikimit mes qytetarëve dhe punonjësve të bashkisë, në zyrat e infomacionit dhe jo vetëm. Respektimi i mekanizmave për transparencën e publikimeve.

Prioritet 10: Buxhetim me pjesëmarrje, proces transparent dhe gjithëpërfshirës në mënyrë që pjesëmarrësit të marrin pjesë në vendimmarrjen mbi menaxhimin e financave publike të pushtetit lokal.

Informacioni i kërkuar më sipër është i rëndësishëm për të vazhduar bashkëpunimin dhe mirëbesimin mes të dy paleve.

Duke ju uruar punë të mbarë, të mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj,

Me respekt,

Mirela JUKA
Drejtoresh Ekzekutive
Organizata RIAS
Tel: 0693443345

Email: organizatarias@outlook.com

27



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim

